



e Rahovecit

Shënohet 35-vjetori i «Flakës së janarit»

Me aktivitete të shumta, u shënua përvjetori i 35-të i «Flakës së janarit».

Në 35-vjetorin e përjetësimit, te vendi i rënies në lakun e Brestocit, Komuna e Rahovesit nderoi kujtimin për heronjtë: Nesimi Elshani nga Nagaci, Agron Fetahu nga Celina, Halim Hoti nga Krusha e Madhe dhe Hilmi Krasniqi nga Hoça e Vogël.

Gjithashtu, për nder të këtij përvjetori, u mbajt një koncert-homazh në qendrën e kulturës «Mensur Zyberaj».

Gjatë aktivitetit, u shpallën gjithashtu fituesit e konkursit për krijimtari letrare, kushtuar Flakës së janarit, ku krijimet artistike na kujtuan fuqinë e fjalës në ruajtjen e identitetit dhe trashëgimisë sonë kombëtare.

Një moment i rëndësishëm ishte ceremonia e dhënies së mirënjohjeve për zonjat e hekurta të shoqërisë sonë, me motivacionin “Për rezistencën kombëtare dhe kontributin në revolucionin e madh që nisi në vitin 1981, duke kulmuar me shtetformimin dhe arritjen e lirisë së plotë të Kosovës”, ku mirënjohje morën: Nëna Stanë, Edita Tahiri, Flora Brovina, Myrvete Dreshaj, Ajshe Gjonbalaj, Florije Osmani, Bademe Gashi, Arbana Qeriqi, Hyrishahe Sylka, Melihate Hoti- post mortem, Ylfete Humolli- post mortem (e pranoi motra Vlora dhe vëllai Arianiti).



Ali Ahmeti dekorohet me «Medaljen e lirisë»

Në shenjë mirënjohjeje dhe nderimi për kontributin e çmuar për çështjen kombëtare shqiptare, Komuna e Rahovecit i jep “Medaljen e lirisë” patriotit të shquar, z. Ali Ahmeti, me motivacionin “Për kontributin e vazhdueshëm atdhetar në të gjitha etapat e historisë më të re kombëtare, për angazhimet e përhershme në funksion të afirmimit kombëtar e ndërkombëtar të çështjes shqiptare dhe për mbrojtjen e vlerave historike të shqiptarëve në trojet e veta”.

